



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep:	
Dep:	2-0
Dep:	
Nr. i fto:	
Bros. shprehja:	02
Nr. paqet:	
Nr. Prot:	
Bros. Prot:	01-332/16
Prot. No:	
Dat.:	
Datum:	28.01.2016
Dat.:	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.01.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4292/15, për zyrtarin e lartë z. Elmaz Zeqiri, Drejtor i Njesisë së Auditimit në Komunën e Vitisë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-4292/15, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Elmaz Zeqiri, Drejtor i Njesisë së Auditimit në Komunën e Vitisë .

Gjatë procesit për identifikimin e rasteve të dyshuara për konfliktit të mundshëm të interesit, është identifikuar rasti për zyrtarin e lartë z. Elmaz Zeqiri, Drejtor i Njesisë së Auditimit në Komunën e Vitisë, është vërejtur se zyrtari i lartë ka të regjistruar një biznes privatë dhe figuron si person i autorizuar ne këtë biznes e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin të funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 24.11.2015 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Elmaz Zeqiri, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-se të ngarkuar me rastin është njoftuar për situatën në të cilën gjendet.

Gjatë komunikimit me zyrtarin është pajtuar me gjendjen por na ka njoftuar se për biznesin në fjalë ka bërë kërkesë për shuarje dhe është zotuar se do të mundohet që brenda afatit ligjor do të sjell dëshmitë lidhur me shuarjen e këtij biznesi .

Me datën 27.01.2016, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se biznesi me emër N.P.T “DAK ” me nr.70678357 është shuar në mënyrë vullnetare.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Elmaz Zeqiri, Drejtor i Njesisë së Auditimit në Komunën e Vitisë, duke bërë shuarjen vullnetare në biznesin privat janë krijuar rrethana të reja dhe konstatohet se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

